

HASAN BELLO**REAGIMI I KLERIT KATOLIK DHE VATIKANIT NDAJ
MIRATIMIT TË KODIT TË RI CIVIL NË VITET 1928-1929
(SIPAS BURIMEVE DIPLOMATIKE ITALIANE)**

Në kuadër të reformave me karakter oksidental, por edhe për nevojat emergjente me të cilat po përballej shoqëria shqiptare në vitet 20-të, ishte parë e domosdoshme që të ngrihej një grup pune me juristë të afirmuar, për të hartuar një Kod të ri Civil. Ky shihej si një projekt emancipues, i cili do ta fuste popullin shqiptar në rrugën e zhvillimit evropian dhe do të shkëpuste përfundimisht ndikimin e legjislacionit osman. Aplikimi i Mexhelesë (Kodit Civil Osman), tashmë konsiderohej i tejkaluar. Ndërtimi i një aparati shtetëror modern, nën shembullin e vendeve evropiane, nuk mund të kuptohej pa hartimin e një korpusi juridik bashkëkohor.¹ Prandaj, juristët e ngarkuar nga Ministria e Drejtësisë gjatë punës së tyre morën në konsideratë disa nga Kodet Civile të vendeve më të përparuara. Mirëpo, ende pa u mbyllur ky proces, raportet që do të krijoheshin nga Kodi i ri Civil lidhur me çështjen e martesës dhe divorcit, ngjallën pakënaqësi tek drejtuesit e kishës.² Sipas informacioneve të konsullatës italiane në Shkodër, kleri katolik ishte duke përgatitur një trazirë kundër institucionit të divorcit të parashikuar nga projekti i Kodit të ri Civil. Argjipeshkvi kishte hartuar një kërkesë të nënshkruar prej katolikëve me autoritet, të cilën do t'ia paraqiste Presidentit të Republikës. Personalitete të njohur nga radhët e deputetëve dhe senatorëve katolikë u nxitën për të bërë përçapje pranë Ahmet Zogut, por ato nuk arritën asnjë rezultat. Kjo situatë ngjalli shqetësimin e autoriteteve italiane, të cilat përpiqeshin të afronin qeverinë me klerin.³

¹ Beqir Meta, "Procesi i ndërtimit kombëtar në vitet 1920-1930", në *100 vjet pavarësi. Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare Tiranë, më 26-27 nëntor 2012*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2014, f. 18-19.

² Fatmira Musaj, *Gruaja në Shqipëri në vitet 1912-1939*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 2002, f. 202-203; Arben Puto, *Shqipëria politike 1912-1939*, Tiranë: Toena, 2009, f. 474.

³ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) Legata italiane, viti (më tej: V.) 1928, dosja (më tej: D.) 143, fl. 8. Letër e konsullit të

Gazeta *Rilindja shqiptare* shkruante me nota kritike ndaj klerit katolik. Ajo merrte si shembull Francën dhe Italinë, vende në të cilat kleri ishte shumë herë më i fuqishëm se në Shqipëri dhe nuk kishte shfaqur asnjë kundërshtim ndaj Kodit Civil. Një qëndrim i ngjashëm vihej re në të gjithë Evropën. Prandaj, ajo kërkonte nga drejtuesit e klerit dhe kishës katolike në Shqipëri të hiqnin dorë nga qëndrimi intrasigjent, duke argumentuar se martesë apo divorci ishin aspekte sociale dhe që s`kishin të bënin aspak me normat fetare.⁴ Qëndrimi i klerit katolik u kundërshtua nga shtypi i kohës, madje edhe nga gazeta që botoheshin jashtë Shqipërisë me argumentin se kur gruaja ishte imorale çfarë duhej të bënte bashkëshorti i saj? A ishte më e moralshme që bashkëshorti të ndahej apo ta vriste me dy plumba sipas zakonisht shqiptar? Në qoftë se jezuitët e Shkodrës i këshillonin burrat që t`i falnin gratë e tyre edhe kur ato i tradhtonin, atëherë kjo këshillë, sipas një autori, mund të vinte nga njerëz të pamartuar. Prandaj, ai bënte thirrje që Shqipëria nuk duhej të udhëhiqej nga influenca fetare.⁵

Në situatën e rënduar mes klerit dhe qeverisë, delegati apostolik Della Pietra transferoi disa klerikë katolikë të Dioqezës së Zadrimës, të cilët njiheshin si mbështetës të Ahmet Zogut. Në mesin e këtyre transferimeve ishte ai i Gaspër Thaçit, vëlla i ish ministrit Kol Thaçi, nga Dajçi në Qelëz me funksione të dekanit dhe titull të Imzotit, dhe ai i dom Nikollë Dedës nga Nenshati në Dardhë. Sipas konsullit italian në Shkodër edhe Deda do të dekorohet me titullin e Imzotit, por një titull i tillë nuk ishte veçse një “pilulë e sheqerosur” nga që famullia e Dardhës, e humbur mes maleve të Pukës, konsiderohej një prej rezidencave më të këqija. Kjo masë shpjegohej me dëshirën për të penguar Dedën, ithtar i njohur i Ahmet Zogut, por i subvencionuar deri pak kohë më parë nga Jugosllavia, që të merrej me politikë. Della Pietra, zhvilloi në Shkodër edhe një mbledhje me të gjithë ipeshkvijtë e Shqipërisë. Ajo kishte si objekt, kryesisht çështjen e divorcit dhe propozimet që Presidenti i Republikës i kishte bërë imzot Bumçit për të bindur klerin të pranonte subvencionin qeveritar, pavarësisht nga përmbyllja e Konkordatit.

përgjithshëm italian në Shkodër, Faralli, për legatën italiane në Durrës dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Shkodër, 15.2.1928.

⁴ “Kodi i ri Civil dhe jeta klerikale e Shkodrës. Kleri katolik kundër martesës civile”, në *Rilindja shqiptare*, nr. 55, Tiranë, 28.1.1928, f. 2.

⁵ “Divorci. Protestat e klerit jezuit të Shkodrës kundër divorcit që përmban Kodi Civil shqiptar”, në *Shqipëri e re*, nr. 315, Kostancë, 25.3.1928, f. 2.

Përfundimi i kësaj mbledhjeje, në gjykimin e konsullit italian të Shkodrës, duke pasur parasysh pikëpamjet e Della Pietras dhe Mjedës, kishte patur rezultat negativ.⁶

Veprimtaria e klerit katolik kundër dispozitave të Kodit të ri Civil erdhi duke u intensifikuar. Në funksion të kësaj fushate u përgatit një broshurë kundër divorcit, e hartuar nga një prift jezuit, të cilën delegati apostolik Della Pietra ia dërgoi Presidentit të Republikës dhe anëtarëve të parlamentit. Një kërkesë e hartuar nga argjipeshkvi Mjeda dhe e nënshkruar nga kleri shkodran iu shpërnda gjithashtu të gjitha dioqezave me qëllim që të firmosej nga famullitarët. Ndërsa senatorëve dhe deputetëve katolikë iu dërgua ta firmosnin, në cilësinë e përfaqësuesve rajonalë katolikë. Por, disa prej tyre nuk pranuan. Kështu, Ejëll Serreqi kundërshtoi propozimin e deputetit Kol Mjeda, duke i lënë liri secilit të pranishëm që të firmosnin si qytetarë, në rast se të gjithë katolikët e njohur do të nënshkruanin. Konsulli italian u frikësua se situata mund të precipitonte në konflikt të hapur mes klerit dhe qeverisë. Ai i kërkoi delegatit apostolik dhe argjipeshkvit Mjeda që ta mbanin kundërshtimin në kufij të arsyeshëm, të moderonin tonin e kërkesës për të mos arritur diçka të kundërt me atë që kërkonin. Gjithashtu u tërhoqi vëmendjen që të tregoheshin të kujdesshëm, se në Shqipëri dhe jashtë saj nuk mungonin njerëz të interesuar të krijonin mosmarrëveshje mes klerit dhe shtetit shqiptar. Madje, i alarmuar prej një situatë të tillë, ai kërkoi ndërhyrjen e MPJ në Romë dhe legatës italiane në Durrës.⁷

Megjithë situatën e tensionuar midis të dyja palëve, ekzistonin edhe linja komunikimi. Këtë rol e luanin kryesisht personalitetet katolike të jetës politike. Ndërmjetësues kryesor mes argjipeshkvit dhe Presidentit të Republikës Ahmet Zogu ishte deputeti Kol Mjeda.⁸ Për të çtensionuar situatën, u organizua edhe një takim i argjipeshkvit Lazër Mjeda me Ahmet Zogun ku u diskutua rreth dispozitave legislative që kishin lidhje me divorcin. Megjithëse ato ishin miratuar nga Parlamenti, A.Zogu arriti

⁶ *AQSH*, F. Legata italiane, V. 1928, D. 143, fl. 9. Letër e konsullit të përgjithshëm italian në Shkodër, Faralli për legatën italiane në Durrës dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Shkodër, më 26.2.1928.

⁷ *Po aty*, fl. 10. Letër e konsullit të përgjithshëm italian në Shkodër, Faralli për legatën italiane në Durrës dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Shkodër, më 28.2.1928.

⁸ *Po aty*, fl. 17. Letër e konsullit të përgjithshëm italian në Shkodër, Faralli për legatën italiane në Durrës, Shkodër, më 10.3.1928.

që ta “zbuste” argjipeshkvin me trajtimin e përzemërt dhe me një farë premtimi mbi mundësinë e shtimit të amendamenteve në periudhën mes miratimit dhe zbatimit të ligjit. Sipas konsullit italian në Shkodër, Mjeda ishte pritur dy herë nga Ahmet Zogu. Një herë bashkë me përfaqësinë e klerit shkodran, ku ishte folur vetëm për divorcin. Ndërsa herën e dytë ishte pritur vetëm, dhe diskutimi ishte përqendruar mbi Konkordatin. Gjatë bisedës, Ahmet Zogu ishte treguar shumë i irrituar me Vatikanin, pretendimet e të cilit, sipas tij, cenonin sovranitetin e shtetit shqiptar. Ai i kishte propozuar që kleri të pranonte subvencionin e qeverisë shqiptare, pavarësisht prej përmbylljes ose jo të Konkordatit, gjë, për të cilën Mjeda ishte përgjigjur se pranonte në parim, por vetëm me miratim paraprak të Vatikanit.⁹

Megjithatë, si Ahmet Zogu ashtu dhe qeveria shqiptare ishte e vendosur rreth çështjes së divorcit. Ky element konsiderohej si një pikë e rëndësishme e Kodit të ri Civil. Prandaj, Presidenti i Republikës i kërkoi deputetit Kol Mjeda që të mos botonte më artikuj kundër divorcit në gazetën *Zani i Popullit*,¹⁰ artikuj këto që mbështesnin hapur vijën e kishës dhe klerit katolik. Kjo e detyroi këtë organ të ndërpriste botimin e një artikulli polemizues me *Gazeta e Korçës* kundër divorcit, i cili ishte frymëzuar fund e krye nga argjipeshkvi.¹¹ *Gazeta Zani i Popullit* një pjesë të financimeve i merrte nga legata italiane, ndërsa pjesën tjetër nga kisha, duke luajtur kështu rolin e mbrojtëses së interesave të klerit katolik.¹²

Përprjekjet e Della Pietra-s për të dobësuar mbështetësit e A.Zogut apo ata klerikë, kryesisht françeskanë, që ishin për gjetjen e një gjuhe kompromisi me qeverinë shqiptare nuk ishin të lehta. Kështu,

⁹ *Po aty*, fl. 18. Letër e konsullit të përgjithshëm italian në Shkodër, Faralli për legatën italiane në Durrës dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Shkodër, më 18.3.1928.

¹⁰ “Nji pyetje e nji lutje. Kleri katolik i drejtohet A. Zogut për ligjin e divorcit dhe për moszbatimin e tij për popullin katolik”, në *Zani i popullit*, nr. 138, Shkodër, 8.4.1928, f. 2-3.

¹¹ *AQSH*, F. Legata italiane, V. 1928, D. 143, fl. 20. Letër e konsullit të përgjithshëm italian në Shkodër, Faralli për legatën italiane në Durrës dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Shkodër, më 23.4.1928.

¹² *Po aty*, fl. 24. Letër e ministrit italian në Tiranë Ugo Sola për konsullin e përgjithshëm italian në Shkodër Faralli, Tiranë, më 27.5.1928. Kjo gazetë subvencionohej pjesërisht, me 10 napolona në muaj, edhe nga konsullata italiane në Shkodër; *po aty*, fl. 39/1-39/2. Letër e konsullit të përgjithshëm italian në Shkodër, Faralli për legatën italiane në Tiranë, Shkodër, më 4.7.1928.

propozimet e delegatit apostolik për emërimin e pasuesit të imzot Kolecit dhe për një sistemim më të mirë të qarqeve dioqeziane të Shqipërisë ndeshën në kundërshtimin e disa ipeshkvijve, të cilët i shkruajtën Vatikanit në lidhje me këtë problem. Madje, disa prej prelatëve vunë në dijeni shumë persona të tjerë kishtarë dhe civilë për propozimet e delegatit apostolik, duke provokuar kundër tij pakënaqësi dhe zemërimin e të gjithë kandidatëve. Veçanërisht të mirditorëve që nuk dëshironin të mbeteshin pa ipeshkvin e tyre dhe, aq më pak, të kalonin në varësinë e imzot Bumçit. Kjo e detyroi Della Pietra-n që të modifikonte propozimet e tij. Ai ngulmoi për transferimin e Imzot Gjonalit nga Mirdita në Zadrimë por, në vend që t'ia bashkote Mirditën Lezhës, i bashkoi Lezhën Mirditës, duke bërë që ipeshkvi i ri të qëndronte gjatë verës në Mirditë dhe gjatë dimrit në Lezhë.¹³

Ahmet Zogu e shihte me shqetësim të madh qëndrimin intrasigjent të klerit katolik. Ai përpiquej të shmange situatën konfliktuale, megjithëse ishte i vendosur për ta miratuar Kodin e ri Civil, pavarësisht kostos që mund të kishte. Kjo vihet re nga takimi që pati me Ugo Sola-n, të cilit i tha se kleri, me urdhër të argjipeshkvijve përkatës, ishte duke mbledhur firma kundër dispozitave të Kodit. Ai i deklaroi ministrit italian, se qeveria shqiptare e konsideronte një propagandë të tillë si veprim antikushtetues që dënohej penalisht.

Ugo Sola iu lut A.Zogut të pezullonte çdo veprim që mund të kishte pasojë për qetësinë e vendit dhe u tregua i gatshëm të ndërhynte për të bindur autoritetet klerikale që të ndërprisnin një agjitacion “jo vetëm të pafryt por edhe të dëmshëm”. Ai kërkoi ndihmën e ministrit të Jashtëm në Romë, të cilit i sugjeroi të komunikonte urgjentisht me delegatin apostolik dhe me argjipeshkvin Mjeda. Sola ishte i bindur se agjitacioni i klerit, nuk ndihmonte për të krijuar një atmosferë ndërmjetësimi për rinisjen e tratativave për nënshkrimin e Konkordatit.¹⁴ Ai bisedoi me argjipeshkvin, të cilit i kërkoi të ndërpriste çdo iniciativë kundër dispozitave të Kodit Civil. Këtu bënte pjesë edhe një qarkore e Mjedës drejtuar vartësve për të mbledhur të gjitha argumentet fetare, sociale dhe politike kundër divorcimit, argumente që ai kishte filluar t'i shtjellonte në

¹³ *Po aty*, fl. 27. Letër e konsullit të përgjithshëm italian në Shkodër, Faralli për legatën italiane në Durrës dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Shkodër, më 20.6.1928.

¹⁴ *Po aty*, fl. 30-31. Letër e ministrit italian në Tiranë Ugo Sola për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Tiranë, më 23.6.1928.

kolonat e *Zani i Popullit* në formën e polemikës me *Gazeta e Korçës*, publikimi i të cilave ishte ndërprerë nga një urdhër presidencial. Sola nuk hezitoi t'i vinte në dukje argjipeshkvit se acarimi i marrëdhënieve me qeverinë ishte në kundërshtim me interesat e katolikëve. Ky qëndrim do ta shtynte shtetin shqiptar drejt masave represive mbi shkollat dhe pasuritë e kishës. Një konflikt i tillë, mbi të gjitha, nuk i shërbente predispozitave të mira të Presidentit të Republikës për nënshkrimin e një Konkordati me Vatikanin.

Kjo ndërhyrje pati efekt pozitiv. Ajo parandaloi përshkallëzimin e konfliktit midis kishës dhe qeverisë shqiptare. Argjipeshkvi Mjeda i premtoi konsullit italian se do ta pezullonte shpërndarjen e qarkores. Por, ai nuk pranoi të ndërpriste mbledhjen e firmave kundër divorcit, për shkak se nuk mund të paraqitej para besimtarëve se kishte ndryshuar mendim. Mbledhja e firmave kishte nisur prej një muaji në të gjitha dioqezat dhe vijonte me më shumë a më pak shpejtësi, sipas frikës së anëtarëve të famullive. Konsulli italian e shihte me rezerva rolin e delegatit apostolik, i cili, nëse nuk ishte frymëzuesi i kësaj iniciative, e kishte parë me sy të mirë këtë veprim. Kjo, sipas konsullit, për të mos humbur popullaritetin e paktë që kishte tek kleri katolik shqiptar.¹⁵

Ndërkohë, fushata e mbledhjes së firmave nuk pati rezultatin e pritur. Në takimin që Faralli zhvilloi me Gaspër Thaçin, administrator i Dioqezës së Zadrimës, mori prej tij sigurime që mbledhja e firmave nuk do të bëhej nga ata famullitarë, së paku deri sa të emërohej titullari i Dioqezës. Priftërinjtë e Mirditës nuk kishin marrë asnjë iniciativë për të mbledhur firma. Faralli i shkruante Sola-s se do t'i mbushte mendjen Mjedës dhe Provincialit të Françeskanëve për ta ndalur një nismë të tillë. Ndërkohë i kërkoi atij të përpiquej të ndikonte mbi imzot Bumçin, i cili gjendej në Tiranë. Në Kryedioqezën e Shkodrës shumica e famullitarëve nuk merreshin seriozisht me mbledhjen e firmave dhe qarkorja e Mjedës synonte, siç theksonte me të drejtë konsulli italian, të shkundte të plogët.¹⁶

Marrëdhëniet e Della Pietra-s me ministrin italian Ugo Sola pësuan një farë acarimi për shkak se autoritetet kishtare pretendonin se qeveria shqiptare dhe Ahmet Zogu gëzonin mbështetjen italiane. Kjo, sipas tyre, i

¹⁵ *Po aty*, fl. 32. Letër e konsullit të përgjithshëm italian në Shkodër, Faralli për legatën italiane në Durrës, Shkodër, më 25.6.1928.

¹⁶ *Po aty*, fl. 33-34. Letër e konsullit të përgjithshëm italian në Shkodër, Faralli për legatën italiane në Tiranë, Shkodër, më 26.6.1928.

jepte qeverisë zemër për ta rritur presionin në drejtim të aprovimit të Kodit të ri Civil dhe reformave që binin ndesh me parimet kanonike. Legjitimimi i divorcit konsiderohej si një pikë që cenonte rëndë principet e besimit katolik. “Në mjedisin muhamedan, në të cilin gjendemi,-shkruante Della Pietra,-nuk dëshirojmë që, për shkak të mungesës së vigjilencës tonë, depozita e besimit të jetë si një djathë i brejtur ngadalë nga minjtë. Bërthama e vogël e katolikëve të dobët mund të zhduket lehtësisht në masën kompakte të ligjit të fëlliqtë të Muhametit”.¹⁷

Duke parë se disa klerikë me origjinë jo shqiptare ishin më kundërshtues ndaj Kodit Civil, Ahmet Zogu nguli këmbë mbi nevojën që të gjithë ipeshkvijtë të ishin shqiptarë. Sipas konsullit italian Faralli, si propozimi rreth subvencioneve, ashtu dhe ngulmimi rreth kombësisë së ipeshkvijve ishin shtysa që synonin të krijonin mosmarrëveshje mes klerit shqiptar dhe Vatikanit, ose, më së paku, me delegatin apostolik. Kjo e kishte shtyrë Mjedën të ndërmerre një sërë takimesh me priftërinjtë e huaj, të cilët i kishin deklaruar se nuk mund ta mbështesnin atë.¹⁸

Diplomacia italiane u përpoq ta pengonte precipitimin e situatës. Në optikën e saj, kjo klimë e acaruar nuk i shërbente as shtetit dhe as katolikëve shqiptarë. Madje, në kushte të tilla, nuk mund të bëhej fjalë për asnjë lloj marrëveshjeje me Vatikanin. Konsulli italian në Shkodër e bindi argjipeshkvin për t'i dërguar një qarkore famullitarëve që të ndërprisnin çdo mbledhje firmash kundër divorcit. Në këtë kohë shumica e famullitarëve as nuk e kishin nisur mbledhjen e firmave. Imzot Mjeda ishte shumë i indinjuar për faktin se iniciativa e tij, konsiderohej nga Presidenti i Republikës si e ndëshkueshme nga Kodi Penal. Ai i deklaroi konsullit Faralli se po tërhiqej vetëm për respektin që kishte ndaj ministrit italian dhe me shpresën, që gjesti i tij të ndikonte pozitivisht në përmbylljen e Konkordatit. Një qëndrim të ngjashëm e kishte aprovuar edhe Provinciali Françeskan. Por kjo nuk garantonte se situata mes klerit dhe qeverisë do të ishte krejtësisht e qetë.¹⁹

Ndërhyrjet e Farallit tek delegati apostolik patën efekt pozitiv. Ai u bind se precipitimi i situatës nuk i shërbente elementit katolik dhe

¹⁷ *Po aty*, fl. 35. Letër e delegatit apostolik Della Pietra për konsullin e përgjithshëm italian në Shkodër Faralli, Shkodër, 1928.

¹⁸ *Po aty*, fl. 36. Letër e konsullit të përgjithshëm italian në Shkodër, Faralli për legatën italiane në Tiranë, Shkodër, 1928.

¹⁹ *Po aty*, fl. 37. Letër e konsullit të përgjithshëm italian në Shkodër, Faralli për legatën italiane në Tiranë, Shkodër, më 28.6.1928.

interesave të kishës.²⁰ Madje, delegati apostolik kërkoi që Ugo Sola të ushtronte ndikimin personal pranë Ahmet Zogut për ta bindur të riniste tratativat për Konkordatin. Kjo shihej me sy të mirë edhe nga Presidenti i Republikës, i cili ishte i gatshëm që Sola të ushtronte ndërmjetësim miqësor pranë delegatit apostolik për të pastruar terrenin nga çdo pengesë me karakter paragjykes rreth Kodit të ri. Këto qëndrime e bindën Sola-n që të luante rolin e ndërmjetësit. Për këtë rol, ai kërkoi miratimin nga MPJ në Romë, duke pasur parasysh interesin e jashtëzakonshëm që paraqiste për Italinë shmangia e armiqësisë së klerit katolik ndaj regjimit të ri. Sipas tij, Presidenti ishte i vetëdijshëm për dobinë që kishte përkrahja e klerit dhe prandaj dëshironte fort që ta përmbyllte Konkordatin me Vatikanin para shtatorit.²¹

Megjithatë tek drejtuesit e klerit katolik dhe sidomos tek delegati apostolik vërehej një farë frike ndaj shtetit shqiptar. Della Pietra e pyeti konsullin Faralli se, nëse Presidenti A.Zogu do të ishte tepër i ashpër me katolikët dhe do të merrte masa shtrënguese në pika delikate si në edukimin etj., a besonte se mund të bëhej një përçapje e katolikëve pranë Lidhjes së Kombeve, ndoshta edhe duke u lutur të konsideroheshin dhe trajtoheshin si një minorancë në një shtet mysliman? A do të fitonte prestigj shteti shqiptar dhe Presidenti prej kësaj? Përkundrazi, nëse do të respektonte sinqerisht atë çka për katolikët ishte e shenjtë, a do të kishte element më të madh progresi se sa katolikët? A mund të bëhej diçka që Presidenti ta kuptonte këtë?²² Propozimet e delegatit apostolik u kundërshtuan nga konsulli italian. Ai i konsideroi ato si veprime të parakohshme dhe u përpoq ta qetësonte Della Pietran.²³

Musolini e aprovoi kërkesën e Ugo Sola-s për të luajtur rolin e ndërmjetësit mes qeverisë shqiptare dhe delegatit apostolik, për të gjetur terren mirëkuptimi mbi çështjen e aplikimit të Kodit të ri Civil dhe për të sheshuar terrenin drejt përmbylljes së Konkordatit. Megjithatë, ai i

²⁰ *Po aty*, fl. 37/1. Letër e konsullit të përgjithshëm italian në Shkodër, Faralli për legatën italiane në Tiranë, Shkodër, më 27.6.1928.

²¹ *Archivio Storico Diplomatico di Ministero degli Affari Esteri*, Roma (më tej: *ASD MAE*), Fondi: Serie Politica 1919-1930, Albania, Pacco 737, fasc. 77. Telegram i legatës italiane në Durrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Romë, 27.6.1928.

²² *AQSH*, F. Legata italiane, V. 1928, D. 143, fl. 39. Letër e delegatit apostolik Della Pietra për konsullin e përgjithshëm italian në Shkodër Faralli, Shkodër, më 3.7.1928.

²³ *Po aty*, fl. 39/1-39/2. Letër e konsullit të përgjithshëm italian në Shkodër, Faralli për legatën italiane në Tiranë, Shkodër, më 4.7.1928.

sugjeroi Sola-s që, në rast se shihte se terreni i mirëkuptimit ishte ende larg dhe kuptonte se marrëveshja e linte të pakënaqur klerin katolik, të gjente mënyrën për t'u tërhequr në kohën e duhur.²⁴

Më 20 qershor 1928, në Shkodër mbërriti një letër papnore e Vatikanit, me të cilën imzot Gjoni emërohej ipeshkv i Zadrimës. Ky emërim nuk i pëlqeu argjipeshkvit, i cili kërkonte të emëronte një kandidat të tij, famullitarin e Shkodrës, imzot Gjura. Këto lëvizje tregonin hapur se mes argjipeshkvit dhe delegatit apostolik, por edhe midis jezuitëve dhe françeskanëve, kishte një mosmarrëveshje të hapur, e cila shprehej në influencimin e autoriteteve vendimmarrëse në Vatikan për të përmbushur kërkesat e tyre.²⁵ Argjipeshkvi i Durrësit Françesko Melkiori ishte një nga ata klerikë që subvencionohej si nga legata italiane ashtu dhe nga Presidenti A.Zogu. Madje, ai shprehej me konsideratë për mbështetjen që ky i fundit jepte për veprimtarinë bamirëse të argjipeshvit, në ndihmë të familjeve të varfra.²⁶

Në këtë periudhë nuk munguan raste kur u shfaq hapur presioni i autoriteteve lokale mbi klerin lidhur me propagandën që ky i fundit zhvillonte kundër Kodit Civil. Kështu, famullitari i Milotit ankohej se krahinari i atjeshëm e kishte thirrur në zyrë dhe i kishte treguar mbi një urdhër qeveritar, i cili do t'u komunikojë famullitarëve të veçantë dhe argjipeshkvit të Kurbinit. Qeveria paralajmëronte që në rast se do t'i kërkonin herë tjetër popullit nënshkrime kundër divorcit të lejuar në Kodin Civil dhe të miratuar nga Presidenti, do të burgoseshin. Kjo e frikësoi tej mase argjipeshkvin e Durrësit Françesko Melkiori, që kishte qenë i detyruar të shpërndante qarkoren e Mjedës e cila, sipas tij, duhej të kishte gjetur edhe miratimin e delegatit apostolik. Prandaj, ai u shtrëngua që të kërkonte mbrojtjen e Ugo Sola-s.²⁷

Këto ngjarje i hapën rrugë dizinformacioneve nga më të ndryshmet. Nga një burim kishtar, informohej MPJ në Romë se Parlamenti Shqiptar,

²⁴ AMAE, Fondi: Serie Politica 1919-1930, Albania, Pacco 737, fasc. 77. Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme në Romë drejtuar legatës italiane në Durrës, 3.7.1928.

²⁵ AQSH, F. Legata italiane, V. 1928, D. 143, fl. 42. Letër e konsullit të përgjithshëm italian në Shkodër, Faralli për legatën italiane në Durrës dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Shkodër, më 4.7.1928.

²⁶ Po aty, fl. 44. Letër e Ordinariatit (Selia) Arkipeshkvnor i Durrësit në Delbinisht (Kurbini) për ministrin e Italisë në Tiranë, Ugo Sola, Kurbini, më 26.7.1928.

²⁷ Po aty, fl. 45. Letër e Ordinariatit (Selia) Arkipeshkvnor i Durrësit në Delbinisht (Kurbini) për ministrin e Italisë në Tiranë, Ugo Sola, Kurbini, më 28.7.1928.

i cili ishte shpërbërë për t'i hapur rrugën mbledhjes së Asamblesë Kushtetuese, tani e tutje, do të përfshinte vetëm ata deputetë që gëzonin besimin e Presidentit të Republikës. Ndërsa deputetët katolikë që kishin kundërshtuar miratimin e Kodit Civil, nuk do të përfshiheshin në listat zgjedhore. Sipas këtij informatori, qeveria shqiptare, do të përqendrohej në dy pika për t'i bërë luftë doktrinës katolike: 1) duke mbështetur divorcin; 2) duke mbështetur shkollat e shtetit kundër atyre private, duke u përpjekur, tërthorazi, t'i ndalonte ato; duke mos u njohur kalimet e klasave dhe duke i dhënë favore frekuentuesve të shkollave të shtetit.

Në këtë drejtim, shteti shqiptar do të shumëfishonte konviktet apo internatet e përziera, ku malësorët e varfër dhe vendasit katolikë gjendeshin në kontakt të parreshtur dhe nën drejtimin e mbikëqyrjen e myslimanëve. Kjo kishte ngjallur reagimin e Episkopatit, i cili, që nga shtatori i vitit 1922, kishte lëshuar urdhëresa të forta që prindërit katolikë (apo të afërmit) që dërgonin bijtë e tyre në të tilla konvikte, të mos pranoheshin në sakramentet kishtarë. Por një thirrje kaq e hapur mund të nxiste autoritetet qeveritare që të merrnin masa ndëshkuese ndaj klerit. Prandaj, delegati apostolik gjykoj se ishte më mirë të kufizonte hapin e përbashkët të episkopatit, duke rekomanduar që çdo famullitar të përpiquej të vinte në dijeni prindërit katolikë për rreziqet dhe dëmet që vinin nga shkollat e përziera, në të cilat bijtë e tyre nuk do të kishin asnjëherë mësim të shëndosha për botën shpirtërore por edhe për të mirën e tyre tokësore. Sipas informatorit, për t'i gjetur rrugëdalje dy të këqijave të parashtruara, mjaft të rënda për katolikët shqiptarë, ishte me vend: 1) që divorci të mos pranohet për katolikët; 2) që konviktet e shtetit të mos ishin të përziera, por veç për myslimanët, dhe veç për katolikët; siç bëhej nga shtetet e mëdhenj që kishin bërthama të fuqishme qytetarësh që ushtronin fe të ndryshme.

Ai sugjeronte gjithashtu t'i tërhiqej vëmendja Presidentit të Republikës se duke pranuar këto dy pika, ipeshkvijtë, kleri dhe të gjithë katolikët e Shqipërisë do ta provonin me fakte se sa leverdi do t'i vinte kombit dhe qeverisë së tij, aq më tepër që kjo përputhej edhe me direktivat e Vatikanit, i cili ngulmonte që katolikëve t'u jepej kjo e drejtë.²⁸

²⁸ *Po aty*, fl. 47-48. Letër e Ministrisë së Punëve të Jashtme në Romë për legatën italiane në Durrës, Romë, më 13.8.1928.

Megjithatë, qeveria shqiptare sillej me konsideratë ndaj delegatit apostolik. Ajo e konsideronte atë si përfaqësues të një shteti fqinj me interesa të drejtpërdrejta shpirtërore në Shqipëri. Kjo vihet re pothuajse në të gjitha ceremonitë zyrtare, ku Della Pietra gëzonte një status të padiskutueshëm. Një vlerësim i tillë u vu re edhe me rastin e shpalljes së monarkisë. Qeveria shqiptare udhëzoi prefektin e Shkodrës t'i bënte të ditur zyrtarisht dhe me kortezi delegatit apostolik për ndryshimin e regjimit dhe lartësimin në fron të Zogut I.²⁹ Kjo vlerësohej jashtëzakonisht edhe nga Ugo Sola, i cili këtë veprim ia raportoi MPJ në Romë, si një akt që shprehte dëshirën për të kapërcyer pikën e vdekur të marrëdhënievet mes Mbretit dhe klerit. Madje, sipas tij, delegati apostolik e kishte pëlqyer tejmasë gjestin shqiptar dhe i kishte telegrafuar menjëherë Vatikanit.³⁰ Me lejen e Selisë së Shenjtë, delegati apostolik kërkoi që, së bashku me argjipeshkvin Mjeda dhe disa përfaqësues të klerit katolik, të kishte një audiencë me Mbretin Zog.³¹ Ai kërkoi ta uronte për kurorëzimin dhe për të treguar se ishte i predispozuar të vazhdonte bashkëpunimin për evitimin e mosmarrëveshjeve.

Me ndërhyrjen e Ugo Sola-s, Mbreti Zog vendosi të priste në audiencë të posaçme delegatin apostolik, së bashku me ipeshkvijtë. Sola i sugjeroi Mbretit që Mjedës dhe përfaqësuesve me influencë të klerit katolik t'i jepte nga një medalje dhe, t'i priste me të gjitha nderimet ushtarake.³²

Më 9 shtator 1928, delegati apostolik, argjipeshkvi, tre ipeshkvë province dhe rektori u nisën nga Shkodra për t'i paraqitur nderimet Madhërisë së Tij, Mbretit Zog I.³³ Në këtë vizitë kortezie tek Mbreti, Mjeda mbajti një fjalim të shkurtër, duke u bazuar mbi parimet fetare të respektit kundrejt autoritetit suprem. Në vijim, bashkë me ipeshkvijtë, ai kishte planifikuar t'i bënte një vizitë Ugo Sola-s për të biseduar mbi çështjet e mëposhtme:

²⁹ *Po aty*, fl. 49. Letër e ministrit italian në Tiranë, Ugo Sola për konsullin e përgjithshëm italian në Shkodër, Faralli, Durrës, më 31.8.1928.

³⁰ *Po aty*, fl. 53. Letër e ministrit italian në Tiranë, Ugo Sola për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Tiranë, më 5.9.1928.

³¹ *Po aty*, fl. 51. Letër e konsullit të përgjithshëm italian në Shkodër, Faralli për legatën italiane në Durrës, Shkodër, më 3.9.1928.

³² *Po aty*, fl. 52. Letër e ministrit italian në Tiranë Ugo Sola për konsullin e përgjithshëm italian në Shkodër Faralli, Tiranë, më 4.9.1928.

³³ *Po aty*, fl. 55. Letër e Melgusci për legatën italiane në Tiranë, Shkodër, më 9.9.1928.

1. Çështjen e Konkordatit dhe divorcit;
2. Subvencionin për klerin;
3. Rreth ndërtimit të selisë famullitare të Shkrelit.³⁴

Ky takim rezultoi i frytshëm për të dyja palët. Pas kthimit nga Tirana Mjeda nuk mungoi të shprehte kënaqësinë e tij rreth rezultatit të udhëtimit, qoftë nga takimi me Mbretin, qoftë nga takimi me Ugo Solan. Ai kishte krijuar përshtypjen se, pas ligjëratës së tij, Zogu kishte mbetur mjaft i ngashëryer dhe i kishte premtuar se do të përdorte të gjitha forcat për mirëqenien e kombit, duke vlerësuar përherë aspiratat e klerit katolik. Argjipeshkvi shpresonte në përmbushjen e këtij premtimi dhe besonte në rolin e Sola-s për rregullimin e raporteve mes Selisë së Shenjtë dhe qeverisë shqiptare. Pas kthimit në Shkodër, priftërinjtë Dom Nikollë Sheldia dhe Dom Nikollë Deda kishin deklaruar në mënyrë konfidenciale se Mbreti Zog u kishte dhënë sigurime se do të bëhej gjithçka për të kënaqur klerin katolik, përsa i përkiste ligjit civil mbi martesën dhe Konkordatin.³⁵

Por ky afrimitet nuk shihej me sy të mirë nga radhët e klerit jezuit, i cili, në pjesën dërrmuese, përbëhej nga priftërinj me origjinë të huaj. Në optikën e tyre, pjesa më e madhe e qeveritarëve shqiptarë ishin regjistruar në urdhrat masonike dhe vepronin sipas parimeve të tyre. Ata mendonin se në Shqipëri elementi katolik ishte më i përparuar, prandaj nuk ishte për t'u habitur që ligjet drejtoreshin veçanërisht kundër katolikëve.³⁶ Ndërsa gazeta *Politika* e Beogradit botoi më 10 tetor 1928 një artikull sipas të cilit kolonia shqiptare në Vjenë ishte njoftuar nga Tirana se Mbreti Zog ishte konvertuar në katolicizëm, dhe se pagëzimi i tij ishte celebruar nga delegati apostolik, Della Pietra. Ky akt, vijonte më tej gazeta, kishte lidhje me planet martesore të Mbretit Zog. Konsulli italian në Shkup raportonte se lajmi kishte shkaktuar përshtypje shumë të keqe mes kolonisë dhe shqiptarëve nënshtetas jugosllavë. Ai ishte një dizinformacion i shtypit serb për të pakësuar entuziazmin e shkaktuar nga

³⁴ *Po aty*, fl. 54. Letër e Sceldia për legatën italiane në Tiranë, Shkodër, më 9.9.1928.

³⁵ *Po aty*, fl. 56. Letër e konsullit të përgjithshëm italian në Shkodër, Faralli për legatën italiane në Durrës, Shkodër, më 12.9.1928.

³⁶ *Po aty*, fl. 58. Përkujtesë paraqitur Sekretarit të Kongregacionit të Shenjtë të Propagandës Fide Imzot Marketi Selvaxhiani, Shkodër, tetor 1928.

kurorëzimi i Ahmet Zogut si Mbret i Shqiptarëve. Në qarqet politike serbe, ky titull kishte ngjallur pakënaqësi të jashtëzakonshme.³⁷

Lajmi mbi bisedimet lidhur me çështjen e Konkordatit ndiqej me interes edhe nga shtypi ndërkombëtar. Ambasadori i Italisë në Spanjë, De Peppo, i shkruante Ministrisë së Jashtme se gazeta *ABC* që dilte në Madrid shkruante se, sipas informatave që vinin nga Vatikani, do të nënshkruhej së afërmi Konkordati mes Selisë së Shenjtë dhe Shqipërisë, mbështetës i zellshëm i të cilit ishte Mbreti Zog.³⁸

Sidoqoftë, marrëdhëniet e Mbretit Zog me klerin katolik u përmirësuan ndjeshëm. Kjo vinte edhe për shkak se klerikët i trembeshin një revanshi të mundshëm të popullsisë myslimane, e cila, sipas regjentit të konsullatës italiane në Shkodër V.Gulli, ziente jo vetëm kundër qeverisë, por edhe kundër katolikëve. Delegati Apostolik, Della Pietra i kishte konfirmuar Gulli-t se katolikët ishin mjaft të kënaqur nga respekti që Mbreti kishte shfaqur ndaj tyre që nga periudha e kurorëzimit. Megjithatë, ai kishte shtuar se kleri nuk ishte i orientuar në mënyrë të qëndrueshme, dhe, për rrjedhojë, as popullsia katolike. Ai mendonte që, në rast të një trazire të elementit mysliman kundër qeverisë, katolikët duhej të rreshtoheshin në përkrahje të kësaj të fundit, nëse do të ishin të sigurt se lëvizja e tyre do të mbrohej. Sipas Della Pietra-s, V.Gulli konkludonte se katolikët do t'i jepnin qeverisë ndihmën e tyre në rast trazirash. Por, para se ta bënin këtë, ata dëshironin të ishin plotësisht të sigurt se nuk do të gjendeshin përballë ndonjë humbjeje, e pastaj dhe shpagimeve. Prandaj, ata dëshironin ta mbështesnin besimin e tyre, më tepër tek Italia se te qeveria shqiptare. Gjatë bashkëbisedimit, Della Pietra i deklaroi gjithashtu V.Gulli-t se elementi katolik ishte kundër çfarëdolloj lëvizjeje në favor të Jugosllavisë. Kjo, pasi një depërtim jugosllav në këtë rajon do të dëmtonte rëndë interesat katolike.³⁹

Kleri katolik ishte i bindur se përpjekja e tij për të bindur qeverinë shqiptare kundër divorcit ishte krejtësisht e kotë. Megjithëkëtë ata

³⁷ *Po aty*, fl. 64. Telekspres i Ministrisë së Punëve të Jashtme në Romë për legatën italiane në Durrës, Romë, 29.10.1928.

³⁸ *AMAE*, Fondi: Serie Politica 1919-1930, Albania, Pacco 737, fasc.77. Telegram i legatës italiane në Madrid drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Romë, 13.10.1928.

³⁹ *AQSH*, F. Legata italiane, V. 1928, D. 143, fl. 65-66. Telekspres i regjentit të konsullatës italiane në Shkodër, V.Gulli për legatën italiane në Durrës dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Shkodër, më 4.11.1928.

mendonin që, përveç mjeteve të tjera, të urdhëronin çdo famullitar të ftonte anëtarët e famullisë së vet, burra e gra nga 15 vjeç e lart të vinin firmën e tyre mbi kërkesën që pasqyronte refuzimin e ligjit të divorcit. Në këtë mënyrë, ata synonin që popullsia katolike të linte për të ardhmen një dëshmi të qartë se kishte kundërshtuar këtë ligj.⁴⁰

Ajo që vihet re, pavarësisht ulje ngritjeve të raporteve mes klerit dhe A.Zogut, është afrimiteti i tij me françeskanët. Marrëdhëniet e mira të Mbretit Zog me françeskanët kishin specifikat e tyre. Ky fakt, zinte fill përpara shpalljes së monarkisë. Prandaj, ata e modifikuan qëndrimin e tyre dhe u përpoqën të afroreshin si me qeverinë ashtu dhe me vetë Mbretin. Françeskanët vlerësonin vëmendjen që Zogu, edhe në cilësinë e Presidentit të Republikës, kishte pasur përherë kundrejt tyre. Ata kishin parasysh veçanërisht ndihmat materiale dhe morale që qeveria shqiptare i kishte dhënë gjimnazit të tyre në Shkodër. Këtu bënë pjesë edhe bursat qeveritare për studentët që mbaronin gjimnazin e françeskanëve, të cilat konsideroheshin si një shenjë dashamirësie e qeverisë. Konsulli italian i Shkodrës i raportonte eprorëve të tij: “Në thelb, kam fituar përshtypjen që françeskanët priren, në momentin aktual, drejt një përafrimi të sinqertë me regjimin dhe me personin e Mbretit”.⁴¹

Deputetët dhe senatorët katolikë mendonin se për të shtuar presionin ndaj qeverisë, përçapja e argjipeshkvit duhej të ishte bërë gjatë paraqitjes në Parlament të masave të njohura legjislative në lidhje me divorcin. Por me që paraqitja tashmë kishte ndodhur dhe që miratuar në parim kalimi i tyre në shqyrtimin e Komisionit, ata menduan që Mjeda të paraqiste sa më shpejt rezervat e tyre, duke u nisur po të nesërmen për në Tiranë.⁴² Në emër të klerit dhe popullit katolik, ai i drejtoi Mbretit Zog një kërkesë.⁴³

⁴⁰ *Po aty*, fl. 67. Telekspres i regjentit të konsullatës italiane në Shkodër, V.Gulli për legatën italiane në Durrës dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Shkodër, më 4.11.1928.

⁴¹ *Po aty*, fl. 68-69. Telekspres i konsullit të përgjithshëm italian në Shkodër, Faralli për legatën italiane në Durrës dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Shkodër, më 16.12.1928.

⁴² *Po aty*, fl. 71. Letër e Cortese për konsullatën italiane në Shkodër, 1928.

⁴³ “*Shk. T. Zotëri Ahmet Zogut*

Shkëlqesi,

Ne të nënshkruarit Arkipeshkv, Ipeshkvë, priftërinj dhe popull katolik i Shqipërisë, duke u bazuar mbi dashamirësinë e njohur të Shk. T., marrim lirinë t’iu parashtrojmë këtë shkrim për t’iu kërkuar përunjësisht një favor që ne e kemi fort për zemër.

Ndërprerja e tratativave dhe komplikimi i situatës për shkak të Kodit të ri Civil nuk i mbyti krejtësisht shpresat për Konkordatin. Delegati Apostolik kërkoi përsëri ndërhyrjen e Sola-s tek Mbreti. Ai synonte që kontakti të fillonte sa më shpejt, që të linte të shpresohej për negociata të ardhshme. Ndërsa kleri u nxit të fillonte një propagandë të dendur për t'i shpjeguar shtresës katolike rreziqet e ligjit mbi divorcin. Sola mbajti një qëndrim të ekuilibruar. Nga njëra anë, ai qetësoi argjipeshkvin dhe duke përfituar nga autorizimi i MPJ, bisedoi me Mbretin, i cili u tregua mjaft i gatshëm për rinisjen e bisedimeve. Ai ngarkoi një prej ministrave të kontaktonte me Sola-n për të shqyrtuar së bashku një formulë pajtuese, të aftë për të kapërcyer çështjet që çuan në dështimin e tratativave të Romës.⁴⁴ Predispozita e tij, u vu re edhe nga fakti, se miratimi i Kodit Civil në Parlament nuk u bë menjëherë. Kuaroni i shkruante konsullit të Shkodrës se Mbreti Zog e kishte shtyrë gjashtë muaj datën e caktuar me qëllim që kleri katolik të unisohej mbi vendimin për ligjin e divorcit.

Në Kodin e ri Civil, që shpejt do të shpallet për të rregulluar sjelljet e popullit shqiptar, kemi vërejtur se është bërë një ligj, sipas të cilit në disa rrethana të caktuara u jepet liri për të zgjidhur martesën të gjithë qytetarëve shqiptarë, ose me fjalë të tjera u jepet liri për të bërë divorcin.

Shkëlqesi! Ne jemi të sigurt se hartuesit e këtij ligji si në çështje të tjera, edhe në këtë kanë pasur si qëllim mbarëvajtjen dhe progresin e popullit dhe jo dëmin e tij; e ndoshta për vëllezërit tanë myslimanë ligji në fjalë përmirëson situatën e familjes duke pakësuar shkaqet e divorcit. Por për ne katolikët, si Shk. J. e di mirë, çështja është krejt ndryshe. Për ne martesë përveçse është një kontratë civile, është edhe një sakrament, domethënë një gjë shumë e shenjtë që i përket thesarit të religjionit. Ne, Jezu Krishti na thotë: quod Deus coniuxi, homo non separat: atë që Zoti ka bashkuar, njeriu nuk mund ta ndajë. Dhe Shën Pali na thotë: kush martohet me një grua të divorcuar bëhet konkubin.

Prandaj ligji i divorcit për ne është jo vetëm rrënimtar pasi dobëson dhe shkallmon familjet tona, por është gjithashtu fyes kundrejt religjionit pasi shkel drejtpërdrejtë një porosi tepër të rëndësishme të Jezu Krishtit.

Shkëlqesi! Për të ruajtur të paprekur këtë religjion, gjatë sundimit aziatik kemi humbur pasuritë tona dhe kemi pësuar fyerje dhe telashe të tjera, gjithashtu për të parë të lirë e të pavarur Shqipërinë kemi vuajtur dhe kemi sakrifikuar edhe jetën; mos lejoni, Ju lutemi që Shqipëria e lirë dhe aq e dëshiruar dhe e ndihmuar prej nesh të na shpërblejë të gjitha këto shërbime me një fyerje kaq të rëndë.

Me shpresën e ngulmët se kjo kërkesë e jona do të mirëpritet nga Shk. J., me respekt iu paraqesim ndjenjat tona më të thella të mirënjohjes". AQSH, F: Legata italiane, V.1928, Dos.143, fl.76-77. Letër e Arkipeshkvit, Ipeshkëve, priftërinjve dhe popullit katolik drejtuar Ahmet Zogut lidhur me ndalimin e ligjit për divorcin.

⁴⁴ AQSH, F. Legata italiane, V. 1929, D. 146, fl. 2. Letër e ministrit italian në Tiranë, Ugo Sola për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Tiranë, më 7.1.1929.

Gjatë kësaj periudhe, ai synonte të riniste tratativat për Konkordatin dhe të thërriste në takim Mjedën për të biseduar mbi këtë temë.⁴⁵

Në bazë të sugjerimeve të legatës italiane, delegatati apostolik kërkoi nga argjipeshkvi Mjeda, të pengonte acarimin e klerit dhe popullsisë katolike në lidhje me divorcin. Ndërhyrja e legatës italiane për qetësimin e situatës ishte vendimtare. Roli i saj së bashku me konsullatën e Shkodrës ndikuan në parandalimin e një përplasjeje mes popullsisë katolike dhe xhandarmërisë. Në rrugë konfidenciale Mjeda kishte deklaruar se imzot Bumçi, në bisedën që kishte zhvilluar me Mbretin mbi çështjen e Konkordatit, ky i fundit i kishte thënë se një çështje e tillë i ishte lënë në dorë ministrit italian në Tiranë. Prandaj, Imzot Bumçi, kishte krijuar përshtypjen se Mbreti dëshironte t'i linte të kuptohej se nënshkrimi i Konkordatit, i dëshiruar prej tij, tashmë varej nga ministri i Italisë. Ai kishte shtuar se veç kësaj i kishte lënë liri të gjerë Sola-s për një marrëveshje me Vatikanin, për të kërkuar një formulë që të mos prekte Kodin e ri Civil dhe, në të njëjtën kohë, të përjashtonte katolikët e Shqipërisë nga ligji i divorcit. Por, përhapja eventuale e këtyre deklaratave sipas regjentit të konsullatës italiane në Shkodër i jepte shkas interpretimeve të ndryshme, të cilat mund të shfrytëzoheshin nga ana e atyre që kishin interes të turbullonin mendjet e njerëzve dhe rendin publik në Shqipëri.⁴⁶ Në përgjigjen për regjentin e konsullatës italiane në Shkodër, Ugo Sola shkruante se ishte e vërtetë që Mbreti Zog i ishte lutur të shqyrtonte, jo me Vatikanin, por me autoritetet shqiptare, një formulë pajtuese për t'i dhënë zgjidhje çështjes së ndërlikuar të Konkordatit dhe divorcit. Ai e vinte në dijeni edhe për faktin se me qeverinë shqiptare po zhvillonte bisedime paraprake, rezultatet e të cilave për momentin rezervohej t'ia bënte të ditura si delegatit apostolik ashtu dhe Mjedës. Megjithatë, ai kërkoi prej tyre që kjo ndërhyrje, të cilën e konsideronte një shërbim thjeshtë miqësor, të mbahej në konfidencialitet të plotë.⁴⁷ Argjipeshkvi Mjeda ishte shumë i kënaqur për misionin e Sola-s dhe mendonte që ky fakt përbënte garanci për klerin dhe popullsinë katolike shqiptare. Ai i deklaroi V.Gulli-t tekstualisht: “Nëse Shkëlqesia e Tij,

⁴⁵ *Po aty*, fl. 4. Letër e Kuaronit për konsullatën e italiane në Shkodër, Tiranë, më 29.8.1929.

⁴⁶ *Po aty*, fl. 5-6. Letër e regjentit të konsullatës italiane në Shkodër, V.Gulli për ministrin italian në Tiranë, Ugo Sola, Shkodër, më 5.1.1929.

⁴⁷ *Po aty*, fl. 7. Letër e ministrit italian në Tiranë, Ugo Sola për regjentin e konsullatës italiane në Shkodër, V. Gulli, Tiranë, më 10.1.1929.

Ministri Sola nuk do të kishte qenë i sigurt të sillte me veprën e tij një përcaktim të kënaqshëm për katolicizmin në Shqipëri, sigurisht nuk do ta kishte pranuar detyrën”. Ndërsa ky i fundit, i përsëriti Mjedës, edhe njëherë, se ministri italian e kishte shumë për zemër çdo çështje që i përkiste religjionit dhe klerit katolik shqiptar. Në të njëjtën kohë, ai i la të kuptojë nevojën e madhe për ta mbajtur tepër sekret rolin e legatës italiane.⁴⁸

Kontradiktat që lindën pas miratimit të Kodit Civil mes shtetit dhe kishës katolike shënuan edhe një incident tjetër. Në janar 1930, famullitari i Vlorës, Dom Marko Vasa, lidhi në martesë nënshtetasin italian Antonio Pano me një nënshtetase shqiptare, e fesë ortodokse. Bashkëshortët u kujdesën që të kryhen, para martesës, shpalljet e saj në konsullatën italiane dhe në famullinë e qytetit. Por kjo u konsiderua nga ana e autoriteteve shtetërore si shkelje e ligjeve. Pasi kaluan pak ditë, Dom Marko Vasa u thirr të paraqitej në gjykatë pasi kishte shkelur detyrimet që diktoheshin nga Kodi i ri Civil, duke celebruar martesën pa kërkuar një çertifikatë nga kryetari i bashkisë për të vërtetuar se shpalljet ishin kryer edhe në bashkinë e Vlorës.

Famullitari u justifikua duke pohuar se nuk e dinte që detyrimi i shpalljeve në bashki i përkiste edhe të huajve. Megjithatë, gjykata shpalli vendimin, duke dënuar Dom Markon me 15 ditë burg dhe me gjobën prej 150 frangash ari dhe, i mohoi përfitimin e dënimit me kusht. Ky vendim, sipas Kuaronit kishte shkaktuar një përshtypje mjaft të hidhur në Vlorë. Kjo për shkak se famullitari kishte vepruar në mirëbesim të plotë. Këtu reflektohej edhe predispozita e qeverisë shqiptare, e cila ishte e vendosur për zbatimin me rigorozitet të legjislacionit të ri. Kjo u vu re nga justifikimet e prokurorit, duke deklaruar se kishte marrë urdhra nga Tirana që të ishte i ashpër, pasi rasti i përkiste një të huaji. Ndërhyrja e legatës italiane në mbështetje të Dom Marko Vasës që ishte treguar përherë e thellësisht i lidhur me Italinë si dhe toleranca e Mbreti Zog, duke pasur parasysh mirëbesimin e priftit të sipërthënë, pati efektin e saj. Mbreti dha urdhër që vendimi i gjykatës së Vlorës të mos zbatohet. Qeveria shqiptare kërkoi që Dom Marko të merrte njoftimin për faljen qoftë me anë të prefektit qoftë përmes prokurorit.⁴⁹ Kjo tregon se shteti

⁴⁸ *Po aty*, fl. 8. Letër e regjentit të konsullatës italiane në Shkodër, V.Gulli për ministrin italian në Tiranë, Ugo Sola, Shkodër, më 16.1.1929.

⁴⁹ *AMAE*, Fondi: Serie Politica 1919-1930, Albania, Pacco 737, fasc. 77. Telekspres i legatës italiane në Tiranë për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, 25.2.1930.

shqiptar, pavarësisht keqkuptimeve që kishte me klerin, nuk ishte për ushtrimin e masave represive.

Argjipeshkvi Mjeda, në bisedimet që zhvilloi me qeverinë shqiptare, u tregua fleksibël lidhur me martesën civile. E vetmja pikë e pakapërcyeshme mbeti çështja e divorcit,⁵⁰ për të cilën ai propozoi që nenet respektive të Kodit Civil të mos aplikoheshin për katolikët. Por kjo u refuzua nga qeveria, e cila nuk mund të lejonte standarde të dyfishta për nënshtetasit e saj. Autoritetet shqiptare ishin të bindur se Mjeda i kishte raportuar Vatikanit në favor të pikëpamjes së tyre. Ato shpresonin që së shpejti kjo çështje të merrte zgjidhje përfundimtare.⁵¹

Sidoqoftë, miratimi i Kodit Civil nuk kishte asnjë tendencë kundër klerit, kishës dhe popullsisë katolike. Përkundrazi, ai synonte emancipimin e vendit dhe shoqërisë. Ai ishte vetëm një nga prioritetet e qeverisë shqiptare për të vënë në zbatim legjislacionin bashkëkohor në përputhje me orientimin oksidental të shtetit shqiptar. Kjo pasqyrohej edhe në programin e qeverisë së Koço Kotës.⁵² Hyrja në fuqi e Kodit Civil konsiderohej si një hap i rëndësishëm drejt rrugës së qytetërimit, për modernizimin e shoqërisë dhe kombit shqiptar.⁵³ Ai shihej si një mjet i domosdoshëm i cili do ta nxirrte Shqipërinë nga prapambetja sociale dhe do ta lidhte kulturalisht me Evropën.⁵⁴

Kjo u shoqërua me një organizim të ri të sistemit gjyqësor, duke përzgjedhur dhe emëruar gjyqtar të arsimuar, me përvojë dhe mentalitetin e nevojshëm për zbatimin e legjislacionit modern. Sigurisht që ky proces

⁵⁰ Kleri katolik e konsideroi çështjen e divorcit si një nga pikat kryesore ku duhej luftuar për të ruajtur integritetin moral të shoqërisë dhe doktrinës katolike. Lazër Mjeda, “Letër e Arqipeshkvit të Shkodrës përmbi Sakramendin e martesës”, në *Fletorja e klerit katolik të Shqypnis*, nr. 9-12, Shkodër, shtator-dhjetor 1929, f. 76-77; “Fjala e Papës përmbi kunorë të shejtë. Mbi enciklikën e Papës Piu XI që dënon letërsinë e artin që ndikojnë në divorcin e prishjen e kurorës”, në *Zani Shna Ndout*, nr. 2, Shkodër: shkurt 1931, f.17-19; Papë Piu XI, “Enciklika e shejtit atë papë Piu XI mi martesën e krishtenë (31 dhjetor 1930)”, në *Lajmëtari i zemrës së Krishtit*, nr. 8-9, Shkodër, gusht-shtator 1931, f.116-119; po aty, nr.10, tetor 1931, f.136-137; po aty, nr. 11 nëntor 1931, f. 153-154; Lazër Mjeda, “Letër e Argjipeshkvit të Shkodrës kundër një shpifjet. (Akte të dioçesave). Kleri katolik dhe Kodi Civil”, në *Fletorja e klerit katolik të Shqypnis*, nr. 1-3, Shkodër, janar-mars 1932, f. 6-7.

⁵¹ *AMPJ*, V. 1930, D. 326, fl. 1. Letër e ministrit të Punëve të Jashtme, Rauf Fico për legatën shqiptare në Romë, Tiranë, më 20.5.1930.

⁵² “Programi i kabinetit të ri”, në *Shekulli i ri*, nr. 170, Durrës, më 22.1.1929, f. 1.

⁵³ T.H, “Kodi Civil i ri”, në *Shekulli i ri*, nr. 175, Durrës, më 26.1.1929, f. 1.

⁵⁴ “Kodi Civil në Shqipëri”, në *Shqipëri e re*, nr. 365, Durrës, më 14.4.1929, f. 2.

hasi në vështirësi të karakterit teknik, të cilat u mendua se do të plotësoheshin gradualisht në përputhje me problematikat që do të dilnin gjatë aplikimit praktik të Kodit të ri Civil. Shtypi i kohës, e konsideronte drejtësinë si pasqyrë në të cilën shfaqej qytetërimi, përparimi dhe lumturia e një kombi.⁵⁵ Miratimi i Kodit të ri Civil u mirëprit dhe gjeti jehonë pothuajse në të gjitha gazetatat më të rëndësishme të kohës.⁵⁶

Ministri i Drejtësisë, Hiqmet Delvina në një letër drejtuar Mbretit Zog me rastin e hyrjes në fuqi të Kodit Civil, e konsideronte 1 prillin si datë historike për Shqipërinë. Sipas tij, kjo kishte bërë që të zhdukeshin normat e të drejtës civile që e lidhnin shoqërinë shqiptare me mentalitetin dhe zakonet e popujve aziatikë, me dogma fetare të papajtueshme me traditën shqiptare dhe në kundërshtim me parimet liberale të Evropës së përparuar. Ky Kod kishte arritur të krijonte një korpus të unifikuar juridik për të gjithë nënshtetasit shqiptarë, pavarësisht përkatësisë fetare dhe krahinore. Ai hidhte bazat e konsolidimit të shtetit kombëtar, i cili kishte në princip laicitetin dhe barazinë e individëve para ligjit. Kodi rregullonte raportet e individëve dhe marrëdhëniet familjare, pa marrë në konsideratë dogmat fetare, duke njohur gjithashtu të drejtën e divorcit; të drejtën e trashëgimisë mbi bazën e afërsisë së gjakut, etj.⁵⁷ Prandaj, me të drejtë, ai u konsiderua si një monument i “pavdekshëm” dhe “madhështor” në historinë e popullit shqiptar që nga koha e Skënderbeut.⁵⁸ Në prefektura të ndryshme të Shqipërisë u organizuan ceremoni festive, ku juristë dhe

⁵⁵ I. L, “Fillimi i prillit inaguron fakte përparimtare me rëndësi. Mbi zbatimin e Kodit të ri Civil”, në *Shekulli i ri*, nr. 208, Durrës, më 3.4.1929, f. 3.

⁵⁶ “1 Prill 1929. Hyrja në fuqi e Kodit të ri Civil”, në *Demokratia*, nr. 200, Gjirokastër, më 30.3.1929, f. 2; “Kodi Civil. Me rastin e hyrjes në fuqi të Kodit Civil të ri”, në *Gazeta e re*, nr. 125, Tiranë, më 31.3.1929, f. 1; “Ditë shënuar për Drejtësinë Kombëtare. Nga telegramet me rastin e hyrjes në fuqi të Kodit të ri Civil”, në *Gazeta e re*, nr. 126, Tiranë, 3.4.1929, f. 1; N.E.T, “Kodi Civil që sot hyri në fuqi. Rëndësia e tij”, në *Gazeta e Korçës*, nr. 597, Korçë, më 1.4.1929, f. 1; “Kodi (Fjalë rumbullake). Për Kodin e ri Civil”, në *Gazeta e re*, nr. 162, Tiranë, më 16.5.1929, f. 1.

⁵⁷ Hiqmet Delvina, “Nalt Madhënia i Tij Zogu I. Mbretit të Shqiptarëve në Tiranë. Me rastin e hyrjes në fuqi të Kodit të ri Civil”, në *Shekulli i ri*, nr. 208, Durrës, më 3.4.1929, f.1; “L’applicativën du nouveau code civil. Telegrami që i ka drejtuar Hiqmet Delvina Mbretit Zog me rastin e hyrjes në fuqi të Kodit të ri Civil”, në *Shqipëri e re*, nr. 366, Kostancë, më 21.4.1929, f. 1; “Hyrja e Kodit Civil në fuqi”, në *Gazeta e re*, nr. 126, Tiranë, më 3.4.1929, f. 1.

⁵⁸ “Monument madhështor. Mbi Kodin e ri Civil”, në *Shekulli i ri*, nr.183, Durrës, më 5.2.1929, f. 1.

avokatë të njohur vlerësuan lart erën e re që po frynte për drejtësinë dhe shoqërinë shqiptare.⁵⁹

Kodi i ri Civil mbështetej kryesisht në të Drejtën Romake (Corpus Juris Civilis). Prandaj, reagimi i klasës së vjetër të juristëve që vinin nga shkolla juridike osmane ishte i pritshëm. Madje, nuk munguan shkrime të cilat i konsideronin ata si “mexhelexhi”.⁶⁰ Kristo Floqi botoi një cikël artikujsh ku shpjegoi në mënyrë të argumentuar avantazhet që kishte zbatimi i Kodit të ri. Ai kritikoi konservatorët, të cilët e paragjykonin atë për shkak të paaftësisë për t’u ambientuar.⁶¹ Kodi i ri, megjithë rezervat e disa qarqeve myslimane në qytetin e Shkodrës, u mirëprit nga pjesa dërrmuese e hoxhallarëve shqiptarë.⁶² Edhe sinodi i Kishës Ortodokse vendosi që të tregojë solidaritet me qeverinë për zbatimin e Kodit Civil.⁶³

Gazeta e Korçës vlerësonte rëndësinë e madhe që dispozitat e Kodit Civil kishin për martesën civile, e cila lehtësonte bashkimin e elementëve të ndryshëm. Me martesën civile, sipas kësaj gazete, binte influenca

⁵⁹ “Telegrame falenderimi për Kodin Civil të ri”, në *Gazeta e re*, nr. 128, Tiranë, më 5.4.1929, f. 1; “Festimi për hyrjen në zbatim të Kodit Civil. Ceremonia e zhvilluar në Elbasan”, në *Shekulli i ri*, nr. 128, Durrës, më 5.4.1929, f. 3; “Kodi Civil i ri. Përshtypjet për vënien e tij në zbatim. Në Gjirokastrë”, në *Gazeta e re*, nr. 133, Tiranë, më 11.4.1929, f. 3-4; “Telegrame që iu dërguan L.M.T. Mbretit, Parlamentit dhe Qeverisë me rastin e hyrjes në fuqi të Kodit Civil të ri”, në *Zëri i Korçës*, nr. 385, Korçë, më 2.4.1929, f. 1; “Populli e pritë me gëzim zbatimin e Kodit të ri Civil”, në *Zëri i Korçës*, nr. 386, Korçë, më 6.4.1929, f. 1

⁶⁰ “Mbi zbatimin e Kodit Civil të ri. Ndryshimi i Kodit me “Mexhelenë” antike”, në *Shekulli i ri*, nr. 178, Durrës, më 30.1.1929, f. 1.

⁶¹ Kristo Floqi, “Mbi zbatimin e Kodit Civil të Ri (Studime e mendime)”, në *Shekulli i ri*, nr. 180, Durrës, më 1.2.1929, f. 2; Kristo Floqi, “Mbi zbatimin e Kodit Civil të Ri (Studime e mendime)”, në *Shekulli i ri*, nr. 184, Durrës, më 6.2.1929, f. 2; Kristo Floqi, “Mbi zbatimin e Kodit Civil të Ri (Studime e mendime)”, në *Shekulli i ri*, nr. 185, Durrës, më 7.2.1929, f. 2.

⁶² Komuniteti Mysliman Shqiptar qëndrimin e vet ndaj Kodit Civil e shprehu qartë. Sipas KMSH-së, anëtarët e këtij komuniteti nuk ishin kundërshtarë të Kodit Civil, pasi e kuptonin se në një vend me disa religjone, çështja e të bërit të ligjeve dhe të aplikimit të tyre nuk i përkiste fesë, por kombit. Ky Kod Civil nuk sillte asnjë pengim në ndërgjegjen e frymëzuar nga feja islame dhe mund të aplikohet nga çdo mysliman.

⁶³ “Sinodhi vendosi që kisha ortodokse të tregojë solidaritet me qeverinë në zbatimin e Kodit Civil”, në *Gazeta e Korçës*, nr. 596, Korçë, më 30.3.1929, f. 1; “Telegrame që iu dërguan L.M.T. Mbretit, Parlamentit dhe Qeverisë me rastin e hyrjes në fuqi të Kodit Civil të ri”, në *Zëri i Korçës*, nr. 385, Korçë, më 2.4.1929, f. 1; “Edhe Sinodhi i Shenjtë në favor të Kodit Civil”, në *Gazeta e re*, nr. 126, Tiranë, më 3.4.1929, f. 1.

fetare dhe vendin e saj e zinte shteti, që ishte i të gjithëve dhe jo vetëm i një pjese, siç ishin fetë.⁶⁴

Qëndrimi intransigjent i klerit dhe kishës katolike në raport me Kodin Civil provokoi shkrime të cilat i bënë thirrje qeverisë të ndërhynte forcërisht për të nënshtuar çdo klerik dhe subjekt fetar ndaj ligjeve të shtetit.⁶⁵ Por, pavarësisht këtyre thirrjeve, shteti shqiptar mbajti një qëndrim të butë, në pritje për t'u mirëkuptuar nga qarqet klerikale.

S u m m a r y

REACTION OF THE CATHOLIC CLERGY AND VATICAN TO THE APPROVAL OF THE NEW CIVIL CODE

In the framework of the reforms of occidental character, but likewise due to the most urgent challenges the Albanian society was facing, it was considered necessary to establish a working group with prominent lawyers, who would draft a new Civil Code. This Code was considered as an emancipatory project, which would place the Albanian people in the path of European development and would eventually detach relations or influence of the Ottoman legislation. Even without ending of the process, relations that would be created by the new Civil Code with the subject of marriage and divorce, caused resentment among church leaders. According to the information of the Italian Consulate in Shkodra, Catholic clergy was preparing turmoil against the institution of divorce provided by the new draft Civil Code.

The archbishop had compiled a petition signed by authoritative Catholics, which would be handed over personally to the President of the Republic. Well-known personalities among catholic deputies and senators were encouraged to make endeavors to Ahmed Zog. But their efforts were useless. The activity of the Catholic clergy against the provisions of the new Civil Code was increasingly intensifying. As part of this campaign a brochure against divorce was compiled by a Jesuit priest, and was sent by the Apostolic Delegate Della Pietra to the President and members of parliament. A request from Archbishop

⁶⁴ “Kodi Civil i ri”, në *Gazeta e Korçës*, nr. 595, Korçë, më 28.3.1929, f. 2.

⁶⁵ Taraboshi, “Shkodra çerdhe fanatizmi. Kleri katolik i Shkodrës mundohet t'i imponojë popullit katolik dogmën se feja e kisha janë ligji i tyre”, në *Shqipëri e re*, nr. 409, Kostancë, më 23.2.1930, f. 1.

Mjeda was signed by the Shkodra clergy and was delivered as well to all dioceses in order to be signed by vicars. Meanwhile Catholic senators and deputies were to sign in the capacity of the regional Catholic representatives. But some of them refused. This attitude of the church and Catholic clergy toward the new Civil Code created a tense situation in relation to the Albanian state, who considered the project as a means of emancipation.